



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1522/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” JSC me seli në Mitrovicë, kundër debitorit Posta e Kosovës (PK SHA Zyra Postare Mitrovicë), duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.814/22 të datës 29.05.2023, me datë 11.03.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” JSC, me seli në Mitrovicë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.814/22 i datës 29.05.2023, dhe çështja gjykohet si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Posta e Kosovës SHA, i ushtruar kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.490/21 datës 06.04.2021 i lejuar nga përmbaruesi privat Atip Mustafa, dhe Mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.490/21 i datës 06.04.2021 i lejuar nga përmbaruesi privat Atip Mustafa.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.814/22 të datës 29.05.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Posta e Kosovës SHA, dhe ka Shfuqizuar Urdhritin Përmbarimor P.nr.490/21 të datës 06.04.2021, të lejuar nga Përmbaruesi privat Atip Mustafa.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” JSC, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave përmbarimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i ankimuar KPPP.nr.814/22 i datës 29.05.2023 të lejohet urdhri përmbarimor P.nr.490/21 dt.06.04.2021.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” JSC me seli në Mitrovicë, me datën 06.04.2021 ka paraqitur propozim për përmbare, kundër debitorit Posta e Kosovës SHA, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës 1034, në shumë të përgjithshme prej 2,450.34€.

Përmbareuesi Privat Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.490/21 të datës 06.04.2021 duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm, faturës së kreditorit, me të cilin ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 2,450.34€.

Debitori në prapësim të ushtruar kundër urdhrin përmbareimor, kundërshton në tërsi propozimin për përmbare nga fakti se përmbareuesi privat ka lejuar ekzekutimin e propozuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 38 dhe 40 si dhe neni 29 të LPP-së. Propozimi i kreditorit është lëshuar në bazë të urdhrin për lejimin e përmbareimit pa u plotësuar kushti ligjor, sepse propozimit nuk ia ka bashkangjitur faturën origjinale sipas së cilës do të shihej shuma e borxhit dhe periudhat e borxhit të parapaguara. Për debitorin është e paqartë dhe pa argumentuar se borxhi paraprak prej 2,450.34€ cilës periudhë kohore i përket, dhe në këtë aspekt debitori e kundërshton propozimin për ekzekutim për shkak të parashkrimit absolut, i propozon gjykatës që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të hedhet poshtë propozimi përmbareimor dhe urdhri përmbareimor P.nr,490/21 dt.06.04.2021.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, për shkak se propozimi për përmbare i plotëson të gjitha kushtet dhe afatet e dokumentit të besueshëm të parapare me ligj, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim për arsye se kërkesat periodike ndërliidhen në raport me person juridik dhe borxhi i kërkuar është për periudhën 01.08.2018 deri 12.03.2021, i propozon gjykatës që të bëhet ekzekutimi i propozimit përmbareimit ndaj debitorit dhe prapësimi të hidhet poshtë si pa bazë ligjore.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.814/22 datës 29.05.2023 me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Posta e Kosovës SHA, dhe ka Shfuqizuar Urdhrin Përmbareimor P.nr.490/21 të datës 06.04.2021, të lejuar nga Përmbareuesi Atip Mustafa.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar dhoma e shkallës së parë ka theksuar se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr.1034 në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbare nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29 par.1 nenp.1.2 të LPP-së.Në dispozitën e lartcekur është përcaktuar se në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afarist sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë,

energji elektrike dhe bartje të mbeturinave. Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përbarim është lejuar sipas një dokumenti nga librat afarist të kreditorit, gjykata gjen se dokumenti mbi bazën e të cilit përbaruesi ka lejuar përbarimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm, nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhomat e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e dhomës së shkallës së parë.

Në këtë rast dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 29, 37 dhe nenin 71 par.1 pika 1.1 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat në lëndë, e mbi të cilën mund të iniciohet procedura e përbarimit.

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti - Kartela Financiare e Konsumatorit me kod 1034, në bazë të së cilës është iniciuar procedura përbarimore, është dokument përbarues dhe i përshtatshëm për përbarim, për faktin se kartela financiare është lëshuar për periudhën 01.01.2013 deri 26.03.2021, në vlerë totale të borxhit prej 2,450.34€, andaj kartela financiare, është dokument i besueshëm, i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përbarim, si dhe i plotëson kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3, 1.4 të LPP-së, që parashohin:

Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;

Dhoma e shkallës së dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e dhomës së shkallës së parë se kartela financiare e kreditorit në bazë të cilit është lejuar urdhri për përbarim, nuk është dokument i besueshëm nga neni 29 paragrafi 1 të LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se dispozitat ligjore të lartcekura kartelën financiare në këtë rast të kreditorit, e përfshijnë si dokument të besueshëm në bazë të cilit realizohet përbarimi, pasi që edhe kartela financiare për periudhën 01.01.2013-26.03.2021 e kreditorit, duhet trajtuar si dokument publik, që është ekstrakt, evidencë e kreditorit për klientët, që paraqet gjendjen e debi-kredisë së klientit, në pagimin e borxhit në këtë rast për periudhën e lartcekur.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.490/21 datës 06.04.2021 i lejuar nga ana e Përmbaruesit privat Atip Mustafa.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1522/23 i datës 11.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha